



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 17-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28. 03. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Diamant Bytyqi, zëdhënës i Komunës

5. Rasim Hasani, drejtor i DA
6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
10. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
11. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
12. Vlorë Krasniqi, zyrtare ligjore
12. Kimete Jashanica, OSBE-së
13. Bukurije Zejnullahu, zyra e informimit
14. Besart Troshupa, zyra e informimit
15. Bestar Ibrahim, i
16. Haki Avdiu,
17. Bekim Krasniqi, OJQ "YHR"
18. Muhamet Qeriqi, OJQ "Polis"
19. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi
3. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës
4. Propozim rregullore për dhënien e dekoratave nga Komuna e Lipjanit
5. Propozim vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për eficiencën e energjisë(PKVEE) 2019-2021

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Nazmi Krasniqi, tha se vërejtje nuk kam por në vitin e kaluar e kemi bërë një planifikim, kemi parapa një raport për arsimin. Është mirë pasi ka pasur grevë dhe problem rreth procesit mësimor të jetë edhe një pikë e tillë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ka qenë më herët e parapame po për shkak të grevës është shty dhe do të shikojmë mundësinë në ndonjë seancë tjetër.

Argjend Tasholli, kërkesë e imja kishte me qenë që në seancën e radhës të parashihet një pikë e rendit të ditës ku banorët e Gadimës së Ulët kanë dorëzuar një kërkesë për një vend për varreza. Kanë dorëzuar një kërkesë zyrës së Kryetarit dhe kanë dëshirë ta dijnë se a do të vijë kjo pikë në Kuvend në seancën e radhës.

Meqë nuk pati vërejtje as plotësime tjera, me të gjitha votat prezente 29 kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, kam një pyetje për ekzekutivin sa ka arritë Komuna rekomandimet e dalura nga MSA-ja dhe ku qëndron komuna jonë. Po ashtu kam edhe dy çështje që i takojnë DKA-së lidhur me eskursionet në Shqipëri. Isha në një mbledhje në gjimnaz në cilësi të prindit ku të gjithë prindët janë për një zgjidhje pasi eskurzioni po vlersohet i dëmshëm për fëmijët e tyre. Po ashtu drejtor në mbledhjen e ardhshme të sjellë një raport për punën e psikologëve nëpër shkolla.

Selatin Retkoceri, deshta të ngrisë një shqetësim të qytetarëve ku jam takuar me një të ri nga fshati Rubovc i cili gjatë bisedës me të më tregoj se si rinia e këtij fshati po e lëshojnë vendin dhe nuk po ka mundësi që as një ekip e futbollit të bëhet nga këta të rinj të tri fshatrave Rubovc i vogël, Kojskë dhe Rubovc i Madh, po ashtu ky i ri tregon se ka përfunduar fakultetin dhe masterin dhe nuk po mund të gjejë punë. Duke e ditur se unë jam këshillëtar komunal më ka lutur ta ngrisë çështjen e këtyre tri fshatrave ku të trija së bashku nuk mund t'i bëjmë 10 nxënës në klasë të parë për shkak të ikjes së numrit të madh të banorëve të këtyre fshatrave. Shtrohet pyetja çka duhet të veprojmë ne për të parandaluar këtë çështje. Migrimi mund të ndalet vetëm me zhvillimin e ekonomisë, me vende të reja të punës etj. Të subvencionojmë bujqësin, pemëtarin, shëndetësi të mirë etj. E kam bërë një studim në fshatin Llugaxhi ku në vitin 2003 kjo shkollë ka pasur 371 nxënës kurse tani ka 222 nxënës. Kjo është mirë Kryetar të bëjmë një statistikë me pa ku po na mbesin qytetarët.

Albulena Kelmendi, unë po i ngrisë tri çështje së pari rruga te "Viva Freshi" një ndërtues që po ndërton aty ka mbetur plotësisht e demolume dhe po i pengon nxënësve që po kalojnë në atë rrugë. Çështja e dytë është çështja e fidaneve janë në gjendje shumë të keqe kisha pasë dëshirë me ju kushtu më tepër vëmendje dhe e treta kërkesë e kahmotshme e qytetarëve të Janjevës dhe Teqës janë për një fshatë Bukovicë i cili është i pa banuar i cili mund të përdorët për çështje bujqësore është problem të arrihet pasi është rruga e pa shtruar ku banorët po kërkojnë së paku rruga të jetë e zhavoruar nëse ka mundësi të bëhet kjo.

Bashkim Budakova, po e ngrisë një çështje të fermerit Arsim Bellaina të fshatit Rubovc që ju ka dëmtua plantacioni i mjedrës nga të reshurat, dëmet kanë qenë të shumta rreth 85% dhe nuk kam dëgju që është kompenzu nga Komuna. Ku ka dalë komisioni dhe i kanë vlerësuar dëmet kanë qenë shumë të mëdha. Kemi pasur një ankesë ku nuk ka pasur as përgjigje as kompenzim. Fermeri Arsim Belloina kërkon përgjigje nga Komuna. Gjithashtu edhe fermeri Florim Budakova ka bërë kërkesë për një motokultivator dhe ndarja nuk ka qenë transparente edhe pse i ka plotësuar kushtet nuk ju ka nda motokultivatori, kërkon përgjigje nga organet kompetente. Kam edhe një pyetje për DKA-në-shkolla e minoritetit serb në fshatin Rubovc sa është e menagjuar nga DKA-ja në Lipjan dhe janë dy qytetarë serbë që ruajnë natën kisha pasur dëshirës a paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Imri Ahmeti, po mundohem me ju dhënë përgjigje në pyetjet e juaja po filloj nga kjo e fundit në pyetjen e Bashkim Budakovës. Nëse bujku ka pasur ankesë për serr apo motokultivator nuk shkruan a ka diplomë apo jo. Me këtë punë ju siguroj se nuk ka pasur militantizëm mundemi lirisht me marrë listën një për një dhe mi pa. Dhe aty ka pasur kritere ata që kanë përfituar në vitin e kaluar nuk kanë marrë. Sa i përket dëmeve të bujqësisë është fond i nivelit qëndror. Komuna nuk është agjension i sigurimit dhe nuk siguron as jetën e qytetarit as dëmet në bujqësi. Dhe Komuna ju ka përgjigj menjëherë zërit të qytetarit. Zyrtarisht e ka bërë vlerësimin dhe zyrtarisht ju ka përgjigj palës dhe e ka dërguar kërkesën në fond për bujqësi. Ju e dini që Komuna nuk ka fond për bujqësi. Çështja e drunjëve dekorativ jemi duke u mundu me u kujdes aq sa kemi mundur. Tash në pranverë do të mundohemi me i ndërru ata drunjë dekorativ që janë dëmtuar. Po ashtu kemi kërkuar nga qytetarët me na ndihmu në ruajtjen e drunjëve. Sa i përket Bukovicës një fshat që me sa duket nuk jeton më askush po kërkohet me u zhavoru kjo rrugë e arave e jo për me jetu. Ne kemi shumë rrugë dhe livadhe. Por mundësitë buxhetore për momentin nuk i kemi. Premja e rrugës te ajo pjesë është riparuar. Kemi një problem KEDSI shpesh bën kërkesë për prerje të rrugës, pastaj pasi të kryen punën nuk e kthen në gjendjen e mëparshme. Shqetësimin që e ngriti Selatini është shqetësim kolektiv nuk është shqetësim individual. Është problem me marrë veprime konkrete me ndalu migrimin. Ne është mirë me i ndalu dukuritë negative që po i ndodhin këtij vendi. Këto dukuri negative që po ndodhin gjenezën e kanë shumë më herët dhe ne nuk mundemi me e ndalu komuna nuk ka kapacitet. Kërkesa e varrezave do të procedohet për Gadimen e Ulët do të shqyrtohet në një seancë tjetër. Gadimes së Ulët një herë ju ka nda një sipërfaqe për varreza nga ky Kuvend. Ne do ta shqyrtojmë këtë kërkesë nëse ka nevojë ky Kuvend do të vendos.

Ramiz Qeriqi, për mua është shqetësuese vrasja e fëmiut nga dora naziste. Është dashtë me reagu na si komunë. Ne nga ky Kuvend kisha kërku me reagu. Dhe të kërkojmë sqarim dhe me kërku nga kush u vra dhe si u vra. Është dashtë me mbajtë një mbledhje komomorative siqë po e mbajmë për veteranët dhe ndonjë anëtarë të partive politike.

Shqetësim i qytetarëve shpesh po ankohen për ujë, nga kati i tretë që nuk ka ujë ditën. Kam dëgjuar nga punëtorët e ujësjellësit se nuk është që nuk ka ujë por nëse lëshohen pompat bëhen shpenzime të mëdha, banorët po mbesin pa ujë shkaku i shpenzimeve të pompave. Unë shpesh bëjë pyetje por nuk marrë përgjigje. Në mbledhjen e kaluar kam kërkuar të dijë se nga kush paguhën OJQ-të dhe si paguhen. Përgjigjja nga Ilir Tasholli për ujësjellësin dhe për te ndërtesa e “Dinos” kur patëm thënë që kanë humbur 100m² nuk kam marrë përgjigje.

Egzona Bytyqi, çështja që po e ngris sot është e karakterit kërkesë departamentit të shëndetësisë. Është një problematikë shumë vjeçare e ngrohëtores QMF-së në Shalë. Aty përveq vështirësive rutinore që kemi çdo ditë, në këtë qendër mjekësore gjatë dy muajve sa punoj aty ishte vështirë akumodimi, ambientimi për shkak të kundërmimit të erës së rëndë prej naftës. E cila shfrytëzohet si karburant i linjës së parë. Andaj kërkoj që çështjen e parashtruar si prioritet i listës së parë, departamenti përkatës për hirë të frekuentimit të madh që ka kjo qendër. Kërkoj që në dimrin e ardhshëm të ju bëhet një zgjidhje.

Ganimete Qeriqi, dua t'i komentoj disa fjale te z. Retkocerit se ka pas fol më herët se fshatit nuk i duhet ndriçimi. E tash po duket se fshatit i duhet ndriçimi edhe shumë bile. Fshatarëve, femrave gjatë shkollimit dhe prej këtu nisnjani vështrore fshatarët dhe rinin në fshat.

Argjend Tasholli, kryetari gjatë fushatës zgjedhore në Gadime ka premtu qerdhe, salla sportive, librari, kompleks sportiv në kodrën e Murturit edhe një park në pishat e Gadimes. Për varrezat që po kërkohet nga lagja Gabrrica, Hashani, Rahmani këtu është fjala për këto tri lagje që po i përmendi.

Imri Ahmeti, një pjesë e premtimeve që po i egzagjeron z. Tasholli nuk janë, një pjesë janë të evidentume dhe të shkrume dhe të dokumentume çka kam fol. Ne po bëjmë përpjekje për t'i përmbushur ato premtime dhe besoj se deri në fund të mandatit do t'i përmbushim. Shumë shpejt do ta kemi në Kuvend lokacionin e ri për ndërtimin e një shkolle fillore në Gadime të Ulët. Ndërsa shkolla egzistuese afër Babushit e cila është e ngjitur ballë për ballë njëra me tjetrën do të shëndrrohet pastaj në qerdhe. E kemi planin tonë dhe do t'i realizojmë premtimet tona.

Selatin Retkoceri, Gane nuk kam thënë asnjëherë fshatit nuk i duhet ndriçimi. Unë kam thënë nuk është prioritet duhet shikohen prioritetet tjera e pastaj ndiçimi. Është absurd të thuhet se fshatit nuk i duhet ndriçimi, kur fshati im Lugaxhi ndoshta është fshati i parë që e ka ndriçimin.

Fadil Sopa,unë dua të propozoj një rregullore komunale që ka të bëj me rregullimin e orarit të punës për objektet afariste të Komunës së Lipjanit. Në këtë rregullore duhet të përfshihet orari verorë dhe dimëror.Kërkoj që të caktohet sakt orari i punës dhe të publikohet në hyrje të lokaleve afariste dhe të ndalohet puna ditën e diel,ose të caktohet një orar kujdestarie siq është puna me barnatoret.Këtë kërkesë e bëj bazuar në Komunat tjera që tash e kanë të rregulluar këtë qështje.Kjo rregullore do të ishte edhe në interes të tregtarëve dhe punëtorëve.

Anila Reqica-Llugiqi,kam një pyetje për drejtorin e DKA-së duke e ditur se shumë lokacione brenda shkollave janë të bllokuara me libra të vjetra dhe ato hapësira nuk po mund të shfrytëzohen dhe të njëjtën kohë ne kemi nevojë për këto hapësira.A keni ndonjë planveprim se si do të veproni me keto hapësira dhe të evitohet ky problem pasi është shumë shqetësues.

Nazmi Krasniqi, e kam një pyetje lidhur me qështjen e kanalizimit në Smallushë i cili është dëmtuar gjatë kohës kur është hapur lumi dhe a ka qenë dikush në teren? A është përmirsuar atje lartë te rruga për varreza.

Imri Ahmeti,qështja që Nazi e ngriti është një kompani për Sillovi dhe Smallushë që do t'i riparoon dëmet nga reshjet e shiut,rrjetin e kanalizimit, trotuaret dhe disa ura me sa duket.Kështu

që pas Gadimës do të shkoj në Smallushë dhe Sillovi. Është një kompani tjetër në Smalushë që ka ndërtuar një rrugë nga Smallusha në Gadime, është e kontraktume nga Ministria do t'i asfaltoj disa rrugë në Smallushë të lagja "puturëve". Çështje e bizneseve për të dielën, disa komuna tjera kanë filluar me rregullativën për pushime të dielën. Kemi një kërkesë të qytetarëve që edhe në komunën e Lipjanit mos të punohet të dieleve. Por jo për të gjitha bizneset sidomos për gastronominë. Për çështjen e ujit drejtori ka qenë këtu dhe të jem real nuk e di që pse nuk ka ujë në katin e tretë. Mos pagesa e ujit është shumë e madhe. Nëse qytetarët nuk fillojnë me pagesën është vështirë me funksionu. Është përqindje e madhe e mos pagesës ku nëpër fshatra paguajnë vetëm 15 deri 20%. Në komuna tjera janë të kushtëzuara me shërbime administrative pagesa e ujit, ndërsa ne si Lipjan nuk kemi hy me këto kushtëzime. Ne duhet të gjejmë mekanizma që qytetarët tanë t'i kryejnë këto obligime, përndryshe nuk do të mundemi me pas shërbime të mira.

Ramiz Qeriqi, te ujësjellësi në kohën e fundit janë duke i nxjerrë paret përmes përmbaruesve e kanë një Rregullore si të kalon faktura mbi 100€. Edhe disa që kanë qenë në gjendje sociale janë detyru me e pagu përmbaruesve. Rregullorja që e propozoj kolega për lokale për të dielën asnjë punëtorë nuk punon 7 ditë por e kanë me rrotacion.

Albulena Kelmendi, puna e ujësjellësit- këtu ka qenë drejtori z. Publica dhe ka raportuar ky raport len për të dëshiruar, këtë çështje shumë herët e kemi ngritë dhe kemi pasur ankesa nga qytetarët se në shumicën e ndërtesave uji nuk shkon në katin e katërt dhe ka reduktime të mëdhaja të ujit. Drejtori nuk e ka adresuar çështjen e pagesës aq sa e ka adresuar humbjen e ujit. Por për shkak të dëmtimit mos sanimit të gypave. Është e vërtetë që kemi borxhe të mëdha. Pavarësisht që është kompetencë e njësisë rajonale të ujësjellësit ne ekzekutivi dhe legjislativi duhet bërë presion. Ne duhet të ndërmarrim diçka sepse është shqetësuese për qytetarët.

Nazmi Krasniqi, çështja e bizneseve për të dielën unë jam për që vetëm a dojnë se mund të punojnë edhe të dielën, nuk jam për t'i ndaluar.

Daut Azemi, kjo ka qenë vetëm kërkesë e bizneseve, kur të vjen Rregullorja në Kuvend atëherë e diskutojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, e kam një vërejtje të vogël kur ka qenë fjala te Kisha kam thënë aty mos të jetë vetëm flamuri i një kombësie serbe sepse ortodoks ka edhe shqipëtarë se për lutje mund të shkojnë edhe kombe tjera. Fjala ime kryesore ka qenë pse të jetë vetëm flamuri Serbisë pasi që aty shkojnë edhe shqipëtarët dhe ky flamur i pengon.

Arben Salihu, vetëm për hirë të transparencës në faqen katër kur kam thënë para 20 vite se imamët dhe priftët mbetën barrë e popullit, e kam bërë një specifikim e kam pasur fjalën për priftërinjtë krishter. I kam përjashtuar priftinjtë ortodoks sepse ata paguhën nga Serbia. Po ashtu Bashkësia Islame dhe kryetari i saj janë në gjendje të vështirë. Unë kam thënë Kryetari i Komunës sepse Kryetari është ai që ndanë lokacione e jo Bashkësia Islame. Bë është ajo që i bënë kërkesat kjo ka qenë fjala ime.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 16-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 votat për

Aprovoi
Ekstraktin nga mbledhja e 16-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi. Duke marr parasysh se banorët e këtij fshati janë dakordu për këtë lokacion si dhe në bazë të kërkesës së këshillit të fshatit Llugaxhi, adresuar Kryetarit të Komunës si dhe petitionit të banorëve rezident dhe 456 nënshkrimeve që ju kanë adresuar komunës sonë.

Lulzim Rrustemi, e kemi diskutuar bukur gjatë dhe besoj që është koha e një kompromisi të përafërt, ka një shumicë e banorëve të fshatit Llugaxhi që janë dakordu për një vend më të mirë dhe më i qetë për shkollën, prandaj ne si grup parlamentar i PDK-së do të ia japim mbështetjen kësaj radhe për t'i mbështet kërkesat legjitime të qytetarëve.

Selatin Retkoceri, përshëndetje për të gjithë sigurisht për delegacionin e fshatit Llugaxhi që kanë ardhur këtu. Dezinformata që ka dalur në publik pro et kontra për Llugaxhin nuk ekziston. Në Llugaxhi nuk ka asnjë qytetar që e kundërshton ndërtimin e Xhamisë. Por për lokacionin ka shumë kundërshtar. Llugaxhia e ka një Xhami dhe nuk na duhet e dyta pse po e themë këtë sepse Llugaxhia do ta ndaj xhematin. Ka paralajmërime se një pjesë e qytetarëve do ta meremetoj Xhaminë e vjetër. Unë nuk jam kundër ndërtimit të Xhamisë as kurrë nuk kam qenë unë jam dhe do të jem kundër ekstremeve të ndryshme. Kush do ta financoj këtë Xhami pasi që fshati nuk ka mundësi të financoj, neve nuk na duhet financimi as i Turqisë as e vendeve arabe. Unë jam për lokacionin e vjetër dhe nuk do ta votoj lokacionin e ri.

Shkelzen Bislimi, tema e lokacionit është hera e dytë që po na vije në Kuvend. Llugaxhija e ka një Xhami të vjetër e që nuk i plotëson nevojat e qytetarëve. Dikur thuhej që për shkak të vjetërsisë kjo Xhami nuk i plotëson kushtet, ndërsa sot kundërshtohet. Nga nënshkrimet e diasporës shihet se ka nënshkrime familjare. Dhe nuk duket e arsyeshme që 100 nënshkrimet e diasporës t'i mposhtin 470 nënshkrimet e banorëve që jetojnë këtu. Pres përkrahjen e anëtarëve të Kuvendit për lokacionin e Xhamisë për fshatin Llugaxhi.

Imri Ahmeti, ka qenë kërkesë e banorëve të fshatit Llugaxhi që 2-3 vite ku më herët ka qenë një lokacion tani janë dy lokacione tjera dhe do të ishte mirë që banorët e këtij fshati të merren vesh, nuk mendoj që është lokacioni më ideal por është lokacioni që i ka bashkua më së shumeti qytetarët. Ju kisha lutë që merrni vendimin e duhur në bazë të kërkesës së qytetarëve.

Arben Salihu, peticioni që ka ardhur nga Anglia me u rrënu një monument i vjetër e me u ndërtua e reja nuk jam i pajtimit, por jam për lokacionin që janë pajtuar shumica e banorëve dhe mendoj që duhet të vendosim mos të zgjatet më tepër për teke të dikujt.

Ramiz Qeriqi, është mirë që lokacioni është pak më largë shkollës edhe unë jam për me e përkah por e kam një kërkesë të Bashkësia Islame të shtëpijat që po bëhen të pamet familjarët që po ju vdesin të afërmit po paguajnë nga 15€. Kisha kërku që kjo pagesë të hiqet te kategoritë e dalura nga lufta, te rastet sociale. Kam edhe një kërkesë të BI, pasi po paguajmë shpenzimet e varrimit familjet që janë raste sociale mos t'i lënë pa i varros për shkak të anëtarësisë që nuk i kanë pagua. Te familjet e dëshmorëve, te kategoritë e dalura nga lufta, te invalidët e luftës për veteran kisha dashtë me u respektu ashtu siqë i respekton shteti.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se sa i përket pagesës është për shpenzime të rrymës që në fshatra bëhet në mënyrë vullnetare e për qytet nuk e dijë.

Arben Salihu, sa i përket kategorive të dalura nga lufta shumica e rasteve lirohen BI e ka një Rregullore të brendshme që një kategori e liron nga pagesa dhe kjo bëhet në pëlqim me këshillin e fshatit. Çështja e kategorive të dalura nga lufta është biseduar brenda BI dhe në të ardhmen do të vendosim si do t'ia bëjmë.

Fehmi Rexhepi, unë e di që BI në komuna tjera siqë është Fushë Kosova, Shtimja rastet sociale janë të liruar nga pagesa. Pse edhe komuna e Lipjanit nuk e merr një vendim me i lirua nga pagesa rastet sociale.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë jam kundër prishjes së Xhamisë së vjetër, pasi është një peticion i qytetarëve unë dhe grupi i ynë jemi pro kërkesës së qytetarëve për ndërtimin e Xhamisë së re.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 24 votat për, 2 kundër, 1 apstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN LLUGAXHI

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet lokacioni për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve të fshatit Llugaxhi me sipërfaqe prej 1000 m² (10 ari) nga pjesa e parcelës kadastrale P-71409047-00325-0 në vendin e quajtur "Slanishte" me kulturë kullosë e klasit 2-të me sipërfaqe totale prej 3396 m² zona kadastrale Llugaxhi, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të bënë parcelimin e sipërfaqës prej 1000 m² të dedikuar për xhami në përputhje me planin zhvillimor komunal dhe njësisë së re kadastrale të krijuar dhe pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e kuvendit komunal.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 15Nr.463-28069 i datës 02.05.2018 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi si dhe Vendimi 15Nr.463-39513 i datës 28.06.2018 për pezullimin e përkohshëm të Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të palujtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tashollit drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim por kërkojmë nga drejtorët të respektohet kodi i veshjes.

Majlinda Sylejmani, edhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Ilir Tasholli, kodi i veshjes është në rregull nuk ka diqka që është në kundërshtim me kodin e veshjes.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 24 votat për të gjitha prezente, aprovoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatshkurtër subjekteve politike që kanë të themeluar degët e tyre në Komunën e Lipjanit, paluajtshmëria-lokali në pronësi të komunës të shënuar më poshtë, e cila gjendet në parcelën kadastrale: P-71409044-01926-0 Zona kadastrale në Lipjan për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

Nr.	Njësia kadastrale	Adresa	Kati	Nr.lokal i	Sipërfaqe m ²
1	O-71409044-01926-0-29-4-17-0	"Lidhja e Prizrenit"	BO	6	81.35m ²

Neni 2

Dhënia e lokalit në shfrytëzim sipas këtij vendimi bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale me destinim për subjekte politike që kanë të themeluara degët e tyre në komunën e Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

Neni 3

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pjesërisht par.1.1 lokali me sipërfaqe prej 81.35 m² i pikës 1 të Vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim rregullore për dhënien e dekoratave nga Komuna e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën i dha fjalën Bekim Shabanit, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim Rregullore, është një dokument i mirë që tregon se qysh duhet dikujt t'i ipen dekoratat dhe ne si grup parlamentar e përkrahim.

Anila Reçica, duke patur parasysh që komuna deri me tani nuk ka pasur një vendim të tillë si të ndahen dekoratat tash e kemi një Rregullore që e specifikon kriteret për ndarjen e dekoratave ne si grup e përkrahim këtë propozim Rregullore.

Daut Azemi, me kërkesë të neni 8 paragrafi 2 aty pas presjes ku shkruan në bazë të aktëgjyqimit të plotëfuqishëm të Gjykatës denohet me denim burgu prej së paku 6 muaj kjo pjesë të hiqet.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregullore dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR DHËNIEN E DEKORATAVE NGA KOMUNA E LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe procedura për dhënien e titujve të nderit - dekoratave, mirënjohjeve dhe medajleve nga Komuna e Lipjanit për qytetarët, personat juridik, shtetasit e huaj dhe organizatat e ndryshme për merita të veçanta dhe kontribut ndaj Komunës së Lipjanit.

Neni 2 Fushëveprimi

Dekoratat si dhe mirënjohjet dhe çmimet tjera ndahen dhe jepen për kontribute të veçanta që kanë dhënë personalitetet e shquara dhe subjektet e tjera juridike, në lëmi të ndryshme si të humanizmit, kontributit kombëtar, kulturor, sportit dhe aktivitete të tjera në Komunën e Lipjanit dhe më gjerë.

Neni 3 Përkufizimet

Me këtë Rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **"Dekoratë"** është çmimi që u ipet personaliteteve vendase ose të huaja si shenjë nderimi për arritje të veçanta personale dhe kontribut të përgjithshëm.

2. **"Mirënjohje"** është çmimi që u ipet qytetarëve të Komunës si shenjë nderimi për kontribut në të mirë të qytetarëve.

3. "**Medalje**" – është çmimi që u ipet qytetarëve të Komunës për arritjet e tyre në fushën e sportit.

II. DEKORATA DHE DHËNIA E TYRE

Neni 4

Llojet dekoratave dhe çmimet që i ndanë Komuna

Llojet e titujve-dekoratave që i jep Komuna e Lipjanit janë:

1. Dekorata - titulli "**Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit**" që u ipet qytetarëve që nuk janë banorë të Komunës së Lipjanit për kontribut të përgjithshëm në të mirë të qytetarëve dhe komunitetit, çështje kombëtare, liri dhe pavarësi.

2. Dekorata - titulli "**Nderi i Qytetit**" për kontribut në promovimin e Komunës u ipet personaliteteve nga Komuna e Lipjanit që me aktivitetin e tyre kanë kontribuar në promovimin e Komunës.

3. Çmimi – titulli "**Finesa**" është dekoratë e veçantë e cila u ipet krijuesve të dalluar të cilët arrijnë suksese të posaçme që mund të mirren si model i kreativitetit në fushën e muzikës, pikturës, skulpturës, filmit, arkitekturës apo lëmi të tjera të artit.

4. Medalje "**Sportisti i vitit**", i ipet sportistit – banorë i Komunës për sukseset e arritura.

5. Çmimi "**Lexuesi më i mire i vitit**", i ipet lexuesit – banorë i Komunës për leximin e librave jo të detyrueshme por nga dëshira për lexim.

6. **Mirënjohje - Falenderime** u ipen personave fizik dhe subjekteve juridike në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë Komunës së Lipjanit dhe qytetarëve të saj.

7. Dekoratat nga paragrafi 1 dhe 2, i këtij neni mund të ipen edhe personaliteteve që tani më nuk jetojnë (post mortum) në nderim të veprës së tyre.

Neni 5

Propozimet për ndarjen e dekoratave dhe çmimeve

1. Dekoratat - titujt "Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit", "Nderi i Qytetit" mund të propozohen për t'u ndarë Kuvendit të Komunës, nga Kryetari i Komunës, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit si dhe 10,000 (dhjetë mijë) nënshkrime nga qytetarë rezident të Komunës me të drejtë vote.

2. Në propozim parashtruesi i propozimit duhet të arsyetoj propozimin e tij me shkrim se kujt i propozon t'i ipet dekorata, qëllimi dhe kontributi i tij/saj.

3. Vendimin për dhënien e dekoratave nga paragrafi 1 i këtij neni e merr Kuvendi i Komunës me votim të shumicës së thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Çmimi "Finesa", Çmimi "Lexuesi më i mirë" dhe Medalja "Sportisti i vitit", ndahet nga Kryetari i Komunës me propozim të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport - për angazhimin dhe arritjen e sukseseve në fushën përkatëse njëherë brenda vitit.

5. Mirënjohje dhe falenderime mund të ndajnë organet komunale brenda fushës së kompetencës së tyre.

Neni 6

Forma dhe dukja fizike e dekoratave

1. Dekorata - titulli “Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit” përbëhet nga:

1.1 Çelësi i madhësisë 20 cm me ngjyrë ari që simbolizon çelësin e qytetit të Lipjanit.

1.2 Pllaketë bronzi me dimensione 21x30 cm të dekoruar, e cila në sfond ka emblemën e Komunës së Lipjanit si dhe një certifikatë solemne të shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare të atij/asaj që i ipet. Përmban të shënuar emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit të shkruara me shkronja të gravuara në radhën e parë, dhe teksti “Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit” në radhën e dytë.

1.3. Çertifikata shkruhet në letër të fortë cilësore së paku 150 gr, formati A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës është Emblema e Komunës së Lipjanit dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës.

2. Dekorata - titulli “Nderi i Qyteti”, përbëhet nga:

2.1 Pllaketë bronzi me dimensione 21x30 cm të dekoruar, e cila në sfond ka emblemën e komunës së Lipjanit, si dhe një certifikatë solemne të shkruar në gjuhën shqipe e cila përmban të shënuar emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit të shkruara me shkronja të gravura në radhën e parë, emërtimin e dekoratës përkatëse në radhën e dytë.

2.2 Çertifikata shkruhet në letër të fortë cilësore së paku 150 gr, formati A4, me ngjyrë argjendi, në sfondin e së cilës është emblema e Komunës së Lipjanit dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës.

3. Çmimi – titulli “**Finesa**” përbëhet nga :

3.1 Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë ku shënohet stema e Republikës

së Kosovës, stema e komunës së Lipjanit, ku shenohet Çmimi “Finesa”.

3.2. Procedura me të cilën ndahet çmimi “Finesa” bëhet nga një juri “ad hoc” e e cila formohet për çdo vit nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

3.3. Çmimi rëndom jepet një herë në vit, por jo domosdoshmërisht.

3.4 . Varësisht nga konkurrenca çmimi mund të ipet më shumë se një personi.

4. Çmimi “Lexuesi më i mirë i vitit” përbëhet nga:

4.1 Çmimi shoqërohet nga një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë ku shënohet stema e Republikës së Kosovës, stema e komunës së Lipjanit dhe shënohet çmimi “Lexuesi më i mirë i vitit”.

4.2 Procedura me të cilën ndahet çmimi “Lexuesi më i mirë i vitit” bëhet nga një juri “ad hoc” e formuar çdo vit nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

4.3. Çmimi rëndom jepet një herë në vit, por jo domosdoshmërisht.

4.4 . Varësisht nga konkurrenca çmimi mund të ipet më shumë se një personi.

5. Medalja “Sportisti i vitit”, përbëhet nga medalje me ngjyrë ari dhe certifikatë solemne të shkruar në gjuhën shqipe që përmban të shënuar emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit dhe emërtimin “sportisti i vitit”.

6 . Mirënjohje dhe falenderimet ipen në formë të certifikatës që përmban të shënuar emrin dhe mbiemrin e bartësit dhe arsyetimin e shkurtë të dhënies.

Neni 7

Dorëzimi i dekoratës

1. Pas Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e dekoratës, Kryetari i Komunës ia dorëzon dekoratën solemnisht të dekoruarit.

2. I dekoruari – bartësi i titullit nënshkruhet formalisht në Regjistrin e Bartësve të Titujve të Nderit, regjistër ky i cili do të mbahet nga Zyrtari për Protokoll i Komunës.

3. Në rast se personaliteti nuk jeton më, pranimin e dekoratës mund ta bëjë anëtar i afërm i familjes apo personi i afërm i të dekoruarit.

Neni 8

Bartja dhe Revokimi i Titujve

1. Bartësi i titullit është i obliguar që titullin ta bartë me dinjitet, duke pasur parasysh çdo herë sjelljet e tij në jetë dhe angazhimin e përditshëm dhe të ruajë autoritetin e Kuvendit të Komunës.

2. Bartësit të titullit mund t'i revokohet titulli, nëse ai me sjelljet e veta në shkallë të lartë konsiderohet që nuk është i denjë për bartjen e titullit.

3. Revokimi bëhet në procedurën e paraparë paraprake si për dhënien e titullit (shpërblimit), ndërsa vendimi përfundimtar merret në mbledhje të rregullt të Kuvendit të Komunës.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Dekoratat dhe titujt e dhëna më parë

Titujt e ndarë para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të konsiderohen valide dhe regjistrohen në Regjistrin e Bartësve të Titujve të Nderit.

Neni 10

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohet Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe Drejtoratet përkatëse Komunale.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Shtesë: Rregullorja.

V

Propozim vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për eficiencën e energjisë(PKVEE) 2019-2021

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tasholli, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, ne përpara e kemi një plan komunal që Bashkimi Evropian në vitin 2007 i ka vu disa kriteret për arritjen e civeve të ndrrimeve klimatike. Edhe në energji për dërgimin e gazrave në atmosfer. Kriteri dytë është 20% e bruto produktit në shtetet e caktuara shpenzohet nga energjia e burimeve të tjera alternative. Kriteri i tretë që lidhet me këtë vendim është reduktimi energjisë përmes eficiencës. Ligji për eficienc i obligon komunat për miratimin e planit komunal para 1 marsit të këtij viti. Ky plan arrit objektivat e komunës për tri vitet e ardhshme dhe komuna ka një plan të energjisë eficiente.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha para se të yjmë në votim te faqja 5 tabela e 4 ku shkruen buxheti i Vushtrrisë duhet të shkruhet i Lipjanit. Njëjtë edhe te faqja 11 e njejtë duhet të përmirësohet. Kjo ka ndodh për shkak që 4-5 komuna e kanë bërë këtë paln.

Megjithatë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (PKVEE) 2019-2021

Neni 1

MIRATOHET, Plani komunal i veprimit për eficiencën e energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal i veprimit për eficiencën e energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11,⁵⁰

**Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**